# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 7970
E enjte, 16 janar 2025
Çmimi 0. 50 €

## Aktakuzë për vrasjen e Liridona Ademajt
FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MBAHET AKADEMI PËRKUJTIMORE PËR 26-VJETORIN E MASAKRËS SË REÇAKUT

# KOSOVA NUK DO TË NDALET SË KËRKUARI DREJTËSI PËR REÇAKUN DHE MASAKRAT E TJERA



Në shënimin e 26-vjetorit të masakrës së Reçakut, përfaqësues të institucioneve të shtetit, atyre lokalë, ambasadori William Walker, përfaqësues të opozitës, deputetë, ambasadorë të akredituar në vendin tonë dhe përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial në Reçak, në nderim të të vrarëve në masakrën e Reçakut. Nga të pranishmit u tha se asnjëherë nuk do të ndalen së kërkuari drejtësi për Reçakun dhe të gjitha masakrat në Kosovë, të cilat mbeten plagë e thellë në historinë tonë

## RRAHMAN JASHARAJ: KRYEMINISTËR, PO TA DËGJOJE ZËRIN TONË, NUK DO TA PRISHJE ZËRIN TËND NË FUSHATË
F. 4



## AUTORITETET E KOSOVËS MBYLLIN INSTITUCIONET SERBE, PROKURORIA THOTË SE S'I AUTORIZOI BASTISJET
F. 5



## AKTUALE



### ARMËPUSHIMI NË GAZË MBETET I LARGËT, NEGOCIATORËT KËRKOJNË MARRËVESHJE
F. 5

### SHQIPËRIA NËNSHKRUAN MARRËVESHJE NJËMILIARDËSHE ME ITALINË DHE EMIRATET E BASHKUARA ARABE
F. 5

### DËSHTON TAKIMI I KOMISIONIT TË PËRBASHKËT KOSOVË - SERBI PËR TË PAGJETURIT NË BRUKSEL
F. 6

## EKONOMI



### KRYETARI I ODËS SË HOTELERISË DHE TURIZMIT, SOGOJEVA: NUK KA PASUR LARGIME MASIVE TË PUNËTORËVE PAS HEQJES SË VIZAVE
F. 8

### PARKU I ERËS NË BAJGORË, PROJEKTI MË I MADH I ENERGJISË SË RIPËRTËRISHME NË KOSOVË
F. 8

## SPORT



### PËRMBYLLET KAMPI STËRVITOR KATËRDITOR ME FUTBOLLISTËT KANDIDATË POTENCIALË PËR PËRFAQËSUESEN A
F. 10

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepcisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Armëpushimi në Gazë mbetet i largët, ndërsa negociatorët kërkojnë marrëveshje

Gaza, 15 janar - Negociatorët po përpiqen t'i finalizojnë hollësitë e fundit të një marrëveshjeje të ndërlikuar armëpushimi në Gazë pas bisedimeve maratonë në Katar që synojnë t'i japin fund konfliktit që ka shkaktuar vdekje dhe shkatërrime masive dhe ka tronditur Lindjen e Mesme.

Bisedimet e gjata, më shumë se tetëorëshe të mërkurën, kishin nxitur optimizëm në Doha të martën. Zyrtarë nga Katari, Egjipti dhe ShBA-ja, si dhe nga Izraeli dhe Hamasi - organizatë e shpallur terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja - thanë se një marrëveshje për një armëpushim në enklavën palestineze dhe për lirimin e pengjeve ishte më afër se kurrë. Por, një zyrtar i lartë i Hamasit i tha "Reuters"-it të martën vonë se grupi palestinez ende nuk kishte dorëzuar përgjigje sepse po priste që Izraeli t'i dorëzonte hartat që tregojnë se si forcat e tij do të tërhiqeshin nga Gaza.

Gjatë bisedimeve disamujore të ndërprera për të arritur një armëpushim në luftën tashmë 15-mujore, të dyja palët kanë thënë edhe më parë se ishin afër një marrëveshjeje vetëm për të hasur në pengesa në minutën e fundit. Pikat e përgjithshme të marrëveshjes aktuale janë vendosur që në mes të vitit 2024.

Nëse ka sukses, armëpushimi i planifikuar me faza mund t'i ndalojë luftimet që kanë shkatërruar Gazën, kanë vrarë dhjetëra mijëra palestinezë, kanë zhvendosur pjesën më të madhe të popullsisë 2.3 milionëshe të para luftës dhe vazhdojnë të vrasin dhjetëra njerëz çdo ditë.



Kjo marrëveshje, nga ana tjetër, mund t'i zbusë edhe tensionet në të gjithë Lindjen e Mesme, ku lufta ka nxitur konflikte në Bregun Perëndimor, Liban, Siri, Jemen dhe Irak, dhe ka rritur frikën për një luftë të përgjithshme midis Izraelit dhe Iranit.

Izraeli nisi sulmin në Gazë pasi luftëtarët e udhëhequr nga Hamasi kaluan kufijtë e tij më 7 tetor 2023, duke vrarë 1 200 njërëz dhe duke marrë më shumë se 250 pengje, sipas të dhënave izraelite. Që atëherë forcat izraelite kanë vrarë më shumë se 46 700 palestinezë në Gazë, sipas zyrtarëve shëndetësorë të enklavës.

Palestinezët shpresonin sërish që bisedimet e fundit të sillnin një lehtësim nga sulmet ajrore izraelite dhe të lehtësonin një krizë humanitare. "Po presim armëpushimin dhe marrëveshjen. Zoti na ndihmoftë për ta përfunduar me të mira! Na dhëntë paqe dhe na lejoftë të kthehemi në shtëpitë tona!", tha Amal Saleh, 54 vjeç, një banore e Gazës e zhvendosur nga lufta. "Edhe nëse shkollat janë bombarduar, shkatërruar dhe rrënuar, ne thjesht duam të dimë se më në fund po jetojmë në paqe", tha ajo.

Sipas planit, Izraeli do t'i rikuperonte rreth 100 pengje dhe trupa të mbetura nga ata të kapur në sulmet e 7 tetorit 2023 nga Hamasi që nxitën luftën. Në këmbim, Izraeli do t'i lironte të burgosurit palestinezë.

Drafti i fundit është mjaft i ndërlikuar dhe përfshin shumë faza. Sipas kushteve të tij, hapat e parë do të përfshijnë një armëpushim fillestar gjashtëjavor.

Plani, gjithashtu, përfshin një tërheqje graduale të forcave izraelite nga Gaza qendrore dhe kthimin e palestinezëve të zhvendosur në veri të Gazës.

Marrëveshja do të kërkonte, gjithashtu, që Hamasi të lironte 33 pengje izraelite, së bashku me hapa të tjerë.

Drafti parasheh që negociatat për një fazë të dytë të marrëveshjes të fillojnë deri në ditën e 16 të fazës së parë. Faza e dytë përfshin lirimin e të gjithë pengjeve të mbetura, një armëpushim të përhershëm dhe tërheqjen e plotë të ushtarëve izraelitë.

Edhe nëse palët ndërluftuese bien dakord për marrëveshjen në tryezë, ende do të ketë nevojë për negociata të mëtejshme përpara se të ketë një armëpushim përfundimtar dhe lirim të të gjitha pengjeve.

Nëse gjithçka shkon pa probleme, palestinezët, shtetet arabe dhe Izraeli duhet të bien dakord për një vizion për Gazën pas luftës, në një detyrë masive që përfshin garanci sigurie për Izraelin dhe miliarda dollarë investime për rindërtimin e Gazës.

Pavarësisht prej përpjekjeve për të arritur një armëpushim, ushtria izraelite, agjencia e brendshme e inteligjencës Shin Bet dhe forcat ajrore sulmuan rreth 50 objektiva në të gjithë Gazën gjatë 24 orëve të fundit, tha Shin Bet dhe ushtria në një deklaratë të mërkurën.

# Kallas: Evropa duhet ta rrisë presionin ndaj Moskës

Moskë, 15 janar - Shefja e politikës së jashtme e Bashkimit Evropian (BE), Kaja Kallas, tha se Kievi dhe partnerët e tij duhet të vazhdojnë të ushtrojnë presion mbi Rusinë për ta përmirësuar pozitën e Ukrainës në çfarëdo negociate eventuale për t'i dhënë fund luftës.

Duke folur më 14 janar në një intervistë për Radion Evropa e Lirë dhe disa gazeta evropiane, Kallas tha se rritja e presionit ekonomik ndaj Moskës dhe izolimi i saj ndërkombëtar janë mënyrat e vetme për ta parandaluar mundësinë që Rusia ta marrë epërsinë. "Nuk duhet t'i nënvlerësojmë aftësitë tona dhe t'i mbivlerësojmë ato të rusëve", tha Kallas. "Rusia nganjëherë duket si një fuqi misterioze që nuk mund të mposhtet. Kjo nuk është e vërtetë. Ne jemi më të fortë si në aspektin ushtarak, ashtu edhe në atë ekonomik. Duhet



t'u qasemi gjërave nga një pozicion force".

Ekonomia ruse ka pësuar disa goditje, si rritjen e normave të interesit mbi 20 për qind, Gazprom-i është detyruar të largojë nga puna 40 për qind të stafit menaxhues të tij, tregu i punës është "në gjendje shumë të keqe" dhe ushtria ruse është detyruar të rekrutojë ushtarë nga Koreja e Veriut për të luftuar në anën e Moskës, tha ajo. "E gjithë kjo tregon se ata nuk janë në një pozicion të mirë", shtoi ajo.

Rusia është e bindur se koha është në anën e saj, por Kallas tha se beson se ky pretendim është i gabuar dhe se aleatët perëndimorë të Kievit duhet ta rrisin më tej presionin ekonomik. "Shohim që rezervat e tyre monetare janë shteruar plotësisht. Ata kanë shumë më pak të ardhura sesa më parë nga shitja e naftës dhe gazit", tha ajo.

# Presidenti i Koresë së Jugut arrestohet pas tentativës për të shpallur gjendje lufte

Suel, 15 janar - Lideri i shkarkuar i Koresë së Jugut, Yoon Suk Yeol, u arrestua të mërkurën për shkak të përpjekjes së tij të dështuar për të shpallur gjendje lufte, duke i dhënë fund një përballjeje disa javore me autoritetet dhe duke u bërë presidenti i parë në historinë e vendit që arrestohet.

Yoon, i cili përballet me akuza për kryengritje pas përpjekjes së tij jetëshkurtër për të shpallur gjendje ushtarake muajin e kaluar, tha se do të bashkëpunonte me hetuesit për ta shmangur "derdhjen e gjakut".

Si një ish-prokuror që udhëhoqi Partinë Konservatore të Fuqisë Popullore (PPP) drejt fitores në zgjedhjet e vitit 2022, Yoon mund të përballet me dënim me vdekje ose burgim të përjetshëm nëse shpallet fajtor për kryengritje. Ai kishte tentuar ta shmangte arrestimin për javë të tëra duke qëndruar në rezidencën e tij, i mbrojtur nga anëtarët e Shërbimit të Sigurisë Presidenciale (PSS) që i kishin qëndruar besnikë.



Rojet e tij kishin vendosur tela me gjemba dhe barrikada në rezidencë, duke e kthyer objektin në atë që opozita e quajti "kështjellë".

Yoon, i cili kishte premtuar të "luftonte deri në fund", arriti ta shmangte përpjekjen e parë për arrestimin e tij më 3 janar, pas një përballjeje të tensionuar disaorëshe midis rojeve dhe hetuesve anti-korrupsion që punonin me policinë. Por, në orët e hershme të së mërkurës, qindra zyrtarë policorë dhe hetues nga Zyra e Hetimeve për Korrupsion rrethuan sërish rezidencën, disa duke u ngjitur mbi muret rrethuese dhe duke kaluar shtigje të fshehta për të arritur te ndërtesa kryesore.

Pas një përballjeje rreth pesëorëshe, autoritetet njoftuan se Yoon ishte arrestuar dhe lideri i shkarkuar publikoi një mesazh të regjistruar paraprakisht. "Vendosa të përgjigjem ndaj Zyrës së Hetimeve për Korrupsion", tha Yoon në mesazh, duke shtuar se nuk e pranonte ligjshmërinë e hetimit, por po bashkëpunonte "për të parandaluar çdo derdhje fatkeqe të gjakut".

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

MBAHET AKADEMI PËRKUJTIMORE PËR 26-VJETORIN E MASAKRËS SË REÇAKUT

# Kosova nuk do të ndalet së kërkuari drejtësi për Reçakun dhe masakrat e tjera

Në shënimin e 26-vjetorit të masakrës së Reçakut, përfaqësues të institucioneve të shtetit, atyre lokalë, ambasadori William Walker, përfaqësues të opozitës, deputetë, ambasadorë të akredituar në vendin tonë dhe përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial në Reçak, në nderim të të vrarëve në masakrën e Reçakut. Nga të pranishmit u tha se asnjëherë nuk do të ndalen së kërkuari drejtësi për Reçakun dhe të gjitha masakrat në Kosovë, të cilat mbeten plagë e thellë në historinë tonë



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 JANAR - Pas homazheve në Kompleksin Memorial në Reçak në kuadër të shënimit të 26-vjetorit të masakrës së Reçakut, në Shtëpinë e Kulturës në Shtime u mbajt akademia përkujtimore, ku morën pjesë përfaqësues të shtetit, deputetë të Kuvendit të Kosovës, kryetarë komunash, ambasadorë të akredituar në vendin tonë, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe qytetarë të shumtë. "Varret e hapura në tokë, plagët e hapura në shpirt, vrragët e mbyllura në trup, arkivat e mbyllura në Beograd. Krimet e kryera gjatë luftës nuk ka qenë e thënë të ndodhin, nuk është dashur të ndodhin, ajo që duhet të ndodhë, për pasojë është drejtësia, gjykimi dhe ndëshkimi i kriminelëve qoftë edhe në mungesë. Në vitet 1998 dhe 1999 thuhej se përfundoi beteja, por jo edhe lufta. Në raport me Serbinë, tash duhet të thuhet e kundërta, ka përfunduar lufta, por jo edhe beteja. Ka mbaruar lufta për çlirim, por jo edhe beteja për drejtësi", u shpreh kryeministri Albin Kurti në hyrje të fjalës së tij.

Në përkujtim të 45 civilëve të vrarë nga forcat e armatosura serbe, kryeministri Kurti potencoi se ndodhen aty për të mos harruar kurrë masakrën e 15 janarit të vitit 1999 si dhe për ta përforcuar kujtesën për masakrën e Reçakut. Ai tha se qeveria ka themeluar grupin punues për ta hartuar detyrën projektuese për kompleksin memorial, si dhe ka miratuar shpronësime të pronave, për përkujtim të dinjitetshëm të masakrës së Reçakut.

Në këtë ceremoni përkujtimore, e cila u organizua nën përkujdesjen e Zyrës së Kryeministrit, kryeministri Kurti falënderoi ambasadorin William Walker, të cilit, siç tha ai, i jemi përjetësisht mirënjohës për humanizmin dhe kontributin e tij gjatë kohës më të vështirë për popullin tonë, ishte dëshmitar i historisë së dhimbshme të popullit tonë, simbol i qëndresës njerëzore dhe i guximit moral.

Duke e cilësuar si një zë i fuqishëm për të vërtetën dhe drejtësinë, atë kohë deklaratat e ambasadorit Walker ishin denoncime zyrtare në emër të Misionit Verifikues të OSBE-së, ndaj forcave dhe autoriteteve serbe që po kryenin krime kundër njerëzimit dhe krime lufte ndaj shqiptarëve civilë në Kosovë, kryeministri Kurti u shpreh se ndihet krenar që Qeveria e Kosovës ka mundësuar botimin e librit të memoareve të ambasadorit Walker, me dëshmi të fuqishme











dhe prekëse mbi tmerrin e masakrës së Reçakut. Sipas tij, ky libër është edhe një urë që lidh brezat përmes kujtesës historike, si dhe është trashëgimi për brezat e rinj që ta njohin luftën së cilës i mbijetuam dhe plagët që ajo la pas. "Përtej së qeni një dokument historik, është edhe një thirrje për kujtesë kolektive dhe për drejtësi", tha kryeministri.

Në këtë ceremoni përkujtimore kryeministri përkujtoi edhe Nusret Shabanin, që i mbijetoi masakrës, teksa e përballoi me një forcë të rrallë vrasjen e të birit 22 vjeçar, Bajrushit. Me këtë rast, kryeministri u shpreh se përkujtojnë qëndresën e tij dhe të të gjitha familjeve të Reçakut, e anekënd Kosovës, që dhanë më të dashurit për lirinë e vendit tonë. Ai shtoi se bashkë angazhohemi që historia e Kosovës dhe liria jonë të jenë gjithmonë shembull i forcës së popullit për të triumfuar mbi padrejtësi. "I përjetshëm qoftë kujtimi për secilën jetë të dhënë në rrugën tonë për çlirimin e Kosovës dhe lirinë e popullit të saj!", përfundoi fjalën e tij kryeministri Kurti në ceremoninë përkujtimore në 26-vjetorin e masakrës së Reçakut.

Në këtë ceremoni përkujtimore fjalë rasti mbajtën edhe ambasadori William Walker, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, kryetari i komunës së Shtimes, Qemajl Aliu, si dhe kryetari i fshatit Reçak, njëherësh përfaqësues i shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, Adem Ramadani.

Homazhe në Reçak kanë bërë edhe liderët e opozitës.

Kryetari i PDK-së dhe kandidati për kryeministër, Bedri Hamza, kanë bërë homazhe në këtë fshat.

Nëpërmjet një postimi në "Facebook", Hamza ka theksuar se si simbol i përpjekjeve për drejtësi dhe si kujtesë kolektive për gjeneratat e reja, do ta ndërtojë memorialin e gjenocidit në Kosovë. "Nder dhe lavdi e përjetshme për të rënët e Reçakut! Kosova e forcuar nga dhimbja, sot kujton me krenari, kërkon drejtësi dhe të vërtetën e saj do ta mbrojë me çdo kusht. Si simbol të përpjekjeve për drejtësi dhe si kujtesë kolektive për gjeneratat e reja, ne do ta ndërtojmë Memorialin e Gjenocidit në Kosovë. E vërteta e popullit tonë do të mbetet e paprekur dhe e mbrojtur për gjeneratat e ardhshme", ka thënë Hamza.

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, pas homazheve në Reçak ka theksuar se sot, 26 vjet më pas, kujtojmë me dhimbje e nderim sakrificën e viktimave të Reçakut dhe qëndresën e familjarëve e të mbijetuarve që bartin ende plagët e asaj tragjedie. "Ky krim mizor është më shumë se një akt brutal dhe një dhimbje kombëtare; është një rikujtim i përjetshëm i çmimit që pagoi populli ynë për liri dhe shtetësi, dhe sakrifica që mundësoi krijimin e shtetit tonë të pavarur dhe realizimin e ëndrrës kombëtare për lirinë që e gëzojmë sot", ka deklaruar Abdixhiku.

Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj dhe kryetari i Nismës, Fatmir Limaj, kanë bërë homazhe në Reçak. "Asnjëherë nuk do ndalemi së kërkuari drejtësi për Reçakun dhe të gjitha masakrat në Kosovë! Masakra e Reçakut mbetet plagë e thellë në historinë tonë, dëshmi e pamohueshme e gjenocidit dhe krimeve serbe ndaj popullit tonë. Në këtë ditë përkujtimi, përulemi me respekt të thellë para sakrificës sublime të 45 civilëve të pafajshëm, të cilët u bënë viktima të barbarisë në zemër të Evropës", ka thënë Haradinaj.

Ai ka pohuar se ky krim i tmerrshëm, që tronditi ndërgjegjen e botës demokratike, shënoi kthesën vendimtare në rrugëtimin tonë drejt lirisë. "Sot, duke nderuar viktimat e Reçakut dhe të gjithë dëshmorët e kombit, jemi më të vendosur se kurrë që Kosova të ecë përpara e sigurt, direkt në NATO, krah aleatëve tanë strategjikë të udhëhequr nga Amerika", ka deklaruar Haradinaj.

## Walkeri kthehet sërish në Reçak: I mahnitur nga numri i njerëzve

26 vjet më parë ishte i pari që i tha botës që në Reçak po kryhet krim kundër njerëzimit. Gati tri dekada më pas shefi i atëhershëm i Misionit Verifikues të OSBE-së në Kosovë, ambasadori William Walker, kthehet në fshatin të cilin dikur pakkush e njihte. Pas homazheve në Kompleksin Memorial, ai tha se është i mahnitur nga numri i madh i qytetarëve që po bëjnë homazhe në këtë kompleks. "Çdo vit mbetem i mahnitur nga numri i njerëzve që vijnë këtu nga e gjithë vendi. Dikur ishte kryesisht një ceremoni përkujtimore e organizuar nga komuna e Shtimes, por tani ka njerëz nga e gjithë Kosova, dhe supozoj se ka edhe nga e gjithë bota. Andaj, ju falënderoj që po e mbuloni këtë [ngjarje]. Ju uroj të gjithëve një ditë shumë të lumtur dhe i uroj gjithë popullit të Kosovës një Vit të Ri të lumtur. Faleminderit shumë!", tha ai.




# Autoritetet e Kosovës mbyllin institucionet serbe, Prokuroria thotë se s'i autorizoi bastisjet

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka njoftuar se nuk e ka autorizuar Policinë e Kosovës për të kryer kontrolle dhe bastisje në lokacionet ku u mbyllën ato pasi, siç ka treguar, nuk kishte ndonjë kërkesë zyrtare

**Prishtinë, 15 janar** - Disa komuna paralele të Serbisë, ashtu si edhe zyra postare dhe tatimore të saj, u mbyllën të mërkurën në dhjetë komuna të Kosovës, në anën jugore të lumit Ibër. Policia e Kosovës tha se qëllim i operacionit ishte ndërprerja e "shërbimeve të jashtëligjshme" të tyre.
Prokuroria Themelore në Prishtinë tha, në anën tjetër, se ajo nuk e ka autorizuar Policinë e Kosovës për kryerjen e këtij operacioni pasi, siç tha, nuk kishte ndonjë kërkesë zyrtare.
Aksione policore u ndërmorën në komunën e Lipjanit, të Obiliqit, të Prishtinës, të Fushë-Kosovës, të Vushtrrisë, të Novobërdës, të Kamenicës, të Vitisë, të Rahovecit dhe të Skenderajt.
Ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla, tha se me këtë veprim "përfundon epoka e komunave dhe institucioneve paralele e kriminale të Serbisë në Republikën e Kosovës".
Në videon që shpërndau ai në rrjetet sociale, u pa edhe ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal të Kosovës, Elbert Krasniqi, duke thënë se "nga sot 28 komunat paralele, kriminale të Serbisë në Kosovë dhe pesë qarqet e tyre, mbyllen përfundimisht".
Autoritetet në Kosovë thonë se puna e këtyre institucioneve serbe, që ishin në funksion që nga paslufta më 1999, është "e paligjshme", dhe nisën mbylljen e tyre qysh në fillim të vitit të kaluar.
Kosova do t'i mbajë zgjedhjet parlamentare më 9 shkurt dhe është në mes të fushatës elektorale.

### A mund të veprohet pa urdhër të prokurorit?

Ehat Miftaraj nga Instituti Joqeveritar i Kosovës për Drejtësi thotë për Radion Evropa e Lirë se Policia e Kosovës nuk mund të kryejë veprime si ato të sotmet pa urdhër të prokurorit kompetent. "Policia mund të arrestojë apo kontrollojë vetëm në rastet kur kryhet një krim flagrant (si vjedhje, grabitje etj.) dhe njoftohet. Por, edhe në këtë rast, në një fazë, prokurori do të njoftohet dhe do të ftohet në vendin e ngjarjes", thotë ai.
Miftaraj shton se "në një shoqëri demokratike të qeverisur nga ligji, veprimi i sotëm do të nënkuptonte pasoja juridike për ata që e iniciuan atë".
Në rastet e mëparshme që kishin të bënin me mbylljen e institucioneve serbe në veri të Kosovës, policia njoftoi se prokurori përgjegjës e kishte cilësuar rastin si "falsifikim dokumentesh".
Në Serbi, kryeministri Millosh Vuçeviq tha se "zhvillimi i situatës" në Kosovë po ndiqet me kujdes. "Do t'i ndërmarrim të gjitha masat për ta mbrojtur popullsinë serbe nga sulmet e reja të Albin Kurtit [kryeministër i Kosovës], i cili, mesa duket, fushatën parazgjedhore e ka shndërruar në vazhdim të keqtrajtimit të popullit tonë", tha Vuçeviq.
Ministri i Jashtëm serb, Marko Gjuriq, e cilësoi aksionin e fundit të autoriteteve të Kosovës si një "përshkallëzim të rrezikshëm". "Këto lëvizje agresive nuk janë vetëm sulm ndaj institucioneve, por edhe përpjekje e hapur për t'i minuar të drejtat kolektive dhe identitetin e serbëve në Kosovë", shkroi Gjuriqi në rrjetet sociale.
Ai tha se komuniteti ndërkombëtar nuk duhet të heshtë, por "t'i mbrojë të drejtat e serbëve në Kosovë".
Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petkoviq - i cili ndodhej në Bruksel, ku do të duhej të mbahej takimi i parë i Komisionit të Përbashkët Kosovë - Serbi për të Pagjeturit, tha se "e ka braktisur atë takim" për shkak të ndodhive në Kosovë. "Kurti nuk do dialog, por dhunë", u tha ai gazetarëve në Bruksel.
I pyetur nëse u mbajt takimi për të pagjeturit, Petkoviqi tha: "Natyrisht që jo. Çështja e të pagjeturve është e rëndësishme... por Kurti e ka mbytur dialogun, e ka mbytur takimin e sotëm". Ai tha se nga mbyllja e institucioneve serbe të mërkurën, mbi 1 100 njerëz kanë mbetur pa punë, por tha se i siguron ata që Serbia do të vazhdojë t'i paguajë.
Në një deklaratë dhënë Radios Evropa e Lirë, Ambasada e ShBA-së në Prishtinë thotë se mbyllja e institucioneve të drejtuara nga Serbia "ndikon drejtpërdrejt dhe negativisht te qytetarët e Kosovës - serbët etnikë dhe komunitetet e tjera - dhe mund t'i minojë aspiratat e Kosovës për t'iu bashkuar komunitetit euroatlantik". "Këto veprime, në kundërshtim me këshillat tona më të mira, e dobësojnë besimin në marrëdhënie dhe kufizojnë aftësinë tonë për ta ndihmuar Kosovën që të sigurojë një të ardhme më të mirë dhe më të ndritshme për të gjithë qytetarët e saj", sipas një zëdhënëse të Ambasadës Amerikane në Kosovë.

### Aksioni - "fushatë parazgjedhore e Vetëvendosjes"

Politologu serb Ognjen Gogiq thotë se aksionin e mbylljes së institucioneve serbe në zonat në jug të lumit Ibër e sheh si "fushatë parazgjedhore" të partisë së Kurtit, Lëvizjes Vetëvendosje. "Aksioni u shoqërua me videoklip të ministrit Sveçla, në të cilin thotë se ka marrë fund prania e Serbisë në Kosovë... sipas tij,

# Shqipëria nënshkruan marrëveshje njëmiliardëshe me Italinë dhe Emiratet e Bashkuara Arabe



TIRANË, 15 JANAR - Shqipëria, Italia dhe Emiratet e Bashkuara Arabe kanë nënshkruar të mërkurën një marrëveshje me vlerë prej të paktën 1 miliard eurove për të ndërtuar një lidhje nëndetare për importim të energjisë së ripërtërishme përmes Detit Adriatik.
Plani do t'i forcojë lidhjet ekzistuese të energjisë elektrike, "të shtrira përgjatë 430 kilometrave në fund të Detit Adriatik, duke lidhur Italinë me Malin e Zi dhe rajone të tjera të Ballkanit... për t'i bërë ato më efikase dhe konkurruese", tha kryeministrja e Italisë, Giorgia Meloni, në Samitin Botëror të së Ardhmes së Energjisë në Abu Dhabi. "Ky partneritet shënon një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të sigurisë energjetike, promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përshpejtimit të tranzicionit drejt energjisë së pastër në rajonin e Mesdheut", thuhet në deklaratën e të tria vendeve.
Marrëveshja me Shqipërinë - aleate e ngushtë politike e qeverisë së krahut të djathtë të Melonit - vjen si shtesë ndaj një projekti për ndërtimin e një lidhjeje elektrike midis Italisë dhe Tunizisë për ta rritur kapacitetin e transferimit të energjisë në rajonin e Mesdheut.
Partneriteti trepalësh do ta përfshijë operatorin italian Terna dhe Kompaninë Kombëtare të Energjisë të Emirateve të Bashkuara Arabe, tha kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama. Ai shtoi se infrastruktura do ta lidhte portin shqiptar të Vlorës me rajonin jugor italian të Pulias, pika më e afërt midis dy vendeve dhe shtoi se kjo pritet të jetë funksionale brenda një maksimumi prej tre vitesh.
Projekti do t'i mundësojë Shqipërisë të shesë energji të ripërtërishme të prodhuar në vend, në një kohë kur vendi po punon drejt diversifikimit të energjisë së saj të ripërtërishme, duke rritur kapacitetin e saj me rreth 500 megavate gjatë dy viteve të fundit, tha për "Reuters" zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku.
"Duke shfrytëzuar ekspertizën botërore të Emirateve të Bashkuara Arabe në energjinë e ripërtërishme, burimet e pasura natyrore të Shqipërisë dhe tregun e sofistikuar të energjisë në Itali, ne po lidhim kombet në një bashkëpunim largpamës", tha Sultan Al Jaber, ministër i Industrisë dhe Teknologjisë së Avancuar të Emirateve të Bashkuara Arabe.

# Rrahman Jasharaj: Kryeministër, po ta dëgjoje zërin tonë, nuk do ta prishje zërin tënd në fushatë



PRISHTINË, 15 JANAR - Rrahman Jasharaj, kryetar i SBAShK-ut, në një reagim për medie, ka thënë se kryeministri në takimet me elektoratin është duke bërtitur shumë dhe deri në fund të fushatës është rrezik të mbetet pa zë dhe kjo nuk është mirë.
"Njeriu bërtet shumë vetëm atëherë kur është i mllefosur e nervoz dhe ju e dini pse jeni. Ti vazhdo me britmat, por unë po ta kujtoj se po ta dëgjoje për këto katër vjet të qeverisjes zërin tonë, pra të punëtorëve arsimorë, të policëve, administratës, zjarrfikësve, pensionistëve dhe qytetarëve plot halle, atëherë do ta ruaje zërin tënd në fushatë sepse në mënyrë të qetë e pa nervozë do ta numëroje plotësimin e kërkesave legjitime të punëtorëve në sektorin publik dhe do të flisje edhe për arritjet në të gjitha sferat e jetës, por në mungesë të kësaj ti s'ke çka bën tjetër përveçse të bërtasësh. Ti dhe qeveria, duke pasur qasje të gabuar e armiqësore ndaj të gjithë atyre që nuk të duartrokitnin kot, le që nuk komunikove me përfaqësuesit e punëtorëve e pensionistëve por, si për inat, veprove në të kundërtën e asaj që ata kërkonin me të drejtë", ka thënë Jasharaj.
Ai ka shtuar tutje: "Ti kryeministër është mirë t'i thuash dikujt nga partia të të zëvendësoj bile në dy a tri tubime, se kështu si po bërtet, do të mbetesh krejt pa zë në gjysmë të fushatës, se janë edhe do ditë deri te dita e zgjedhjeve. Por, ta kuptoj hallin se, ndoshta, edhe nuk ke kujt t'ia besosh këtë detyrë, se ata ose do të mundohen të të kopjojnë e të bërtasin, ose të nisin e të këndojnë siç bëri ministrja Nagavci. Ajo, mbase, duke u frikësuar se ministre nuk do të zgjidhet kurrë më, ka dashur të provojë se mos po merr popullaritet si këngëtare", ka thënë Jasharaj.

një prani paralele dhe ilegale. Ata nuk mund të tregojnë asgjë tjetër si rezultat, kështu që kjo [mbyllja e institucioneve serbe] është pjesë e fushatës së tyre", thotë Gogiqi për Radion Evropa e Lirë.
Ai shton se partia në pushtet "po e instrumentalizon politikisht edhe Policinë e Kosovës për të bërë fushatë".
Mbylljen e pothuajse të gjitha institucioneve serbe në jug të Ibrit, Gogiq e lidh edhe me ardhjen në pushtet të administratës së re amerikane.
Autoritetet e Kosovës duan "t'i kryejnë veprimet e tilla para se Donald Trumpi të hyjë në Shtëpinë e Bardhë", sipas tij.
Gogiqi thekson se institucionet e Serbisë në Kosovë nuk do të shfuqizohen derisa Beogradi zyrtar ta vendosë një gjë të tillë, por nuk e përjashton mundësinë që punonjësit e tyre të ndiqen penalisht.
Në korrik të vitit 2024 Prokuroria e Ferizajt mori në pyetje punonjës të autoritetit të përkohshëm komunal të Shtërpcës, nën dyshimet për "rrënim të rendit kushtetues të Kosovës".
Përfaqësues të shoqërisë civile i thanë më herët Radios Evropa e Lirë se punëtorë të tjerë në institucionet e financuara nga buxheti i Serbisë mund të përballen tani me akuza të njëjta.

### Cilat institucione u mbyllën?

Policia e Kosovës mbylli më 8 janar Administratën Tatimore në Mitrovicën e Veriut, e cila funksiononte në kuadër të sistemit të Serbisë, për shkak të, siç u tha, "aktiviteteve të paligjshme", si dhe kompaninë e sigurimeve nga Serbia "Dunav Osiguranje", për shkak të dyshimeve se punonte pa licencë.
Kosova nisi mbylljen e institucioneve serbe qysh në janar të vitit 2024, duke ua vënë fillimisht drynin organeve të përkohshme komunale të Dragashit, Suharekës, Prizrenit dhe Rahovecit, të cilat gjendeshin në jug të lumit Ibër.
Pastaj u mbyllën organet e përkohshme komunale të Pejës, Istogut, Klinës, Skenderajt, si dhe ato në komunat në veri: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.
Ndërkohë u mbyllën edhe degët e Postës së Serbisë në veri të Kosovës, kasaforta e Bankës Popullore të Serbisë në Leposaviq, Banka Kursimore e Postës, Zyra për Kosovën e Qeverisë së Serbisë, Drejtoria e Fondit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, Qarku Administrativ Kosovë - Mitrovicë dhe Qendra për Punë Sociale në Vushtrri.
Të gjitha këto institucione me mijëra punëtorë funksiononin në sistemin e Serbisë.

# Dështon takimi i Komisionit të Përbashkët Kosovë - Serbi për të Pagjeturit në Bruksel




**Kryetari i Komisionit Qeveritar të Kosovës për Personat e Zhdukur, Andin Hoti, ka reaguar pas dështimit të takimit, duke e quajtur arsyetimin e delegacionit serb "banal" dhe "të dëmshëm për procesin e zbardhjes së fatit të personave të zhdukur"**

PRISHTINË, 15 JANAR - Takimi i parë i Komisionit të Përbashkët të Kosovës dhe Serbisë për të pagjeturit, i planifikuar të mbahej të mërkurën në Bruksel, dështoi të mbahej pasi që delegacioni i Serbisë refuzoi të marrë pjesë, në shenjë proteste pas aksionit të Qeverisë së Kosovës për mbylljen e institucioneve të Serbisë.

Në Bruksel delegacioni i Kosovës u takua me përfaqësues të ekipit të të dërguarit të BE-së për dialog, Miroslav Lajçak. REL-i merr vesh se ekipi evropian ka pasur takime edhe me delegacionin e Serbisë, por jo në kuadër të takimit të Komisionit të përbashkët.

Kryetari i Komisionit Qeveritar të Kosovës për Personat e Zhdukur, Andin Hoti, reagoi në llogarinë e vet në "Facebook" pas dështimit të takimit, duke e quajtur arsyetimin e delegacionit serb "banal" dhe "të dëmshëm për procesin e zbardhjes së fatit të personave të zhdukur". "Kjo demonstron për të disatën herë mungesën e gatishmërisë së Serbisë për të bashkëpunuar në këtë çështje të rëndësishme. Kjo tregon edhe njëherë politizimin e tejskajshëm të Serbisë në raport me çështjen e personave të zhdukur", ka shkruar Hoti.

Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petkoviq, tha se "e ka braktisur atë takim" për shkak të ndodhive në Kosovë. "Kurti nuk do dialog, por dhunë", u tha ai gazetarëve në Bruksel.

I pyetur nëse u mbajt takimi për të pagjeturit, Petkoviqi tha: "Natyrisht që jo. Çështja e të pagjeturve është e rëndësishme... por Kurti e ka mbytur dialogun, e ka mbytur takimin e sotëm". "Besoj se Lajçaku ka bërë gjithçka që ka mundur, por mund të ishte bërë edhe më shumë dhe të kishte më shumë mirëkuptim për popullin serb në Kosovë, sepse për një gjë të tillë kemi paralajmëruar gjatë gjithë kohës", tha Petkoviq.

Por, burimet e REL-it thanë se Petkoviqi nuk ishte i supozuar të merrte pjesë në takim. Po ashtu, sipas njoftimeve të mëhershme të BE-së, takimi ishte parashikuar të ishte vetëm takim i Komisionit për të Pagjeturit dhe jo takim i radhës në kuadër të dialogut, ku do të merrnin pjesë kryenegociatorët.

Në takim delegacioni i Kosovës do të udhëhiqej nga Halil Cenaj, qysh edhe kishte bërë me dije kryetari i Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur, Andin Hoti.

Ndërkaq Serbia para takimit të paralajmëruar nuk kishte bërë me dije se kush do ta udhëheqë delegacionin e saj.

Në reagimin e tij, Hoti u shpreh i befasuar për pjesëmarrjen e Petkoviqit dhe tha se "prania e tij është dëshmia më e qartë se pikërisht ai orkestroi dhe garantoi dështimin e takimit të paraparë, duke e kthyer një proces teknik jetik në një mjet të turpshëm të politizimit dhe obstruksionit".

Të mërkurën autoritetet e Kosovës njoftuan se kanë mbyllur organet komunale serbe në dhjetë komuna në jug të lumit Ibër, si dhe zyrat postare dhe të Administratës Tatimore të Serbisë.

Kosova kishte filluar mbylljen e institucioneve serbe qysh në fillim të vitit 2024. Pas aksionit të fundit, autoritetet në Serbi thanë se do t'i marrin të gjitha masat "për ta mbrojtur popullin serb" në Kosovë.

### Çfarë është Komisioni i Përbashkët Kosovë - Serbi për të Pagjeturit?

Ngritja e këtij komisioni është bërë në bazë të një marrëveshjeje të arritur vitin e kaluar në kuadër të dialogut për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian, për zbatimin e Deklaratës për Personat e Zhdukur.

Sipas Kryqit të Kuq, në Kosovë janë ende 1 612 persona të pagjetur nga lufta.

Sipas burimeve në BE, në takimin e së mërkurës nuk pritej ndonjë veprim konkret, por pritej që ai të ishte një takim më shumë i karakterit simbolik dhe ceremonial.

Burimet në Bruksel kishin thënë se takimi do të duhej të shërbente si rast që palët t'i paraqisnin prioritetet e tyre dhe të merreshin vesh për datat e takimeve të ardhshme.

Në dhjetor të vitit të kaluar Kosova dhe Serbia ishin pajtuar ta formonin këtë komision të përbashkët për ta zbatuar Deklaratën dhe BE-ja e kishte cilësuar si një nga rezultatet më të rëndësishme të dialogut vitin e kaluar.

Deklarata politike ishte arritur në maj të vitit 2023 ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Megjithatë, deri më tani nuk është bërë ndonjë veprim konkret për zbatimin e saj, teksa familjarët e më shumë se 1 600 personave të pagjetur - kryesisht shqiptarë - me ankth presin të dinë për fatin e më të dashurve të tyre.

Një nga ta është edhe Fitim Dubovci, i cili kërkon babanë e tij të zhdukur në luftën e fundit në Kosovë më 1998-1999. "Babanë e kanë marrë të gjallë, por, sot, vetëm 1 për qind besoj se mund të jetë i gjallë diku", tha ai për REL-in në prill të vitit 2024.

Fitimi nga Çikatova e Drenasit, përveç babait, ka edhe pesë familjarë të tjerë të zhdukur. "Sa e sa familjarë të personave të zhdukur tashmë kanë vdekur 'me sy hapur', sepse nuk e kanë ditur ku i kanë më të dashurit e tyre", tha ai.

BE-ja ka thënë më herët se për zbatimin e Deklaratës për Personat e Zhdukur duhet funksionalizimi i Komisionit të Përbashkët. Megjithatë, në të kaluarën palët kishin akuzuar njëra-tjetrën për mungesë të gatishmërisë për të dhënë informacione për të pagjeturit si dhe mungesë të qasjes në dokumente relevante dhe arkiva ushtarake të rëndësishme për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur.

Në Deklaratën për Personat e Zhdukur thuhet se palët angazhohen për identifikimin e vendeve të varrimit dhe më pas që në to të gërmohet.

Aty, po ashtu, palët pajtohen të ofrojnë qasje të plotë në informacione të besueshme dhe të sakta që do të ndihmonin në gjetjen dhe identifikimin e personave të zhdukur në periudhën 1 janar 1998 - 31 dhjetor 2000. "Kjo përfshin të gjitha materialet, shënimet, urdhrat, dokumentet, videot, audio-incizimet dhe çdo dokument tjetër - përfshirë edhe ato që kanë statusin e klasifikuar - nën posedimin e institucioneve të të dyja palëve, që janë të rëndësishme për këtë kontekst", thuhet në Deklaratë.

Në këtë Deklaratë nuk përmenden arkivat ushtarake apo policore, që Kosova ka kërkuar që Serbia t'i hapë pasi thotë se në to janë edhe informacionet për të zhdukurit. Megjithatë, aty përmenden dokumentet me status të klasifikuar që, sipas njohësve, iu referohet dokumenteve konfidenciale apo arkivave shtetërore ushtarake dhe policore, të cilat, sipas tyre, do të ndihmonin në gjetjen e personave të pagjetur.

Kosova ka kryer gërmime në lokacione të ndryshme ku dyshohet për mbetje mortore të personave të vrarë gjatë luftës, por autoritetet shpesh kanë thënë se problemi qëndron në lokacionet në Serbi, ku dyshohet se janë varrosur viktimat e luftës në Kosovë.

Në rajon nga konfliktet në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë zbardhja e fatit të personave të zhdukur, po ashtu, është pjesë e punës së komisioneve të përbashkëta mes këtyre shteteve.

## Bordi i ShSKUK-së miraton planin strategjik 2025-2027 dhe planin vjetor 2025

PRISHTINË, 15 JANAR - Në mbledhjen e 65-të Bordi Drejtues i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) ka miratuar planin strategjik 2025-2027 dhe planin vjetor 2025 për Njësinë e Auditimit të Brendshëm të ShSKUK-së. Mbledhjen e hapi kryesuesi i Bordit Drejtues, Dren Boshnjaku, i cili fjalën e kaloi te Besnik Zejnullahu, u. d. drejtor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm - ShSKUK, për ta paraqitur strategjinë, por edhe planin e auditimit për vitin 2025, përfshirë njësitë dhe sektorët që planifikohen të auditohen, por edhe auditimet specifike, me kërkesë.
Në këtë mbledhje drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, Elvir Azizi, raportoi për punët dhe aktivitetet që janë realizuar dhe që janë në procedurë të realizimit në ShSKUK. Pas mbledhjes, anëtarët e Bordit Drejtues - ShSKUK, vizituan Klinikën e Biokimisë dhe Shërbimin Klinik të Mikrobiologjisë.
Gjatë vizitës drejtori i Klinikës së Biokimisë, Shemsi Veseli dhe drejtoresha e Shërbimit Klinik të Mikrobiologjisë, Greta Lila, shpjeguan punën që bëhet në këto dy njësi, treguan arritjet, sfidat, planet dhe kërkesat që kanë për zhvillim të mëtejmë të shërbimeve për pacientë.



# Aktakuzë për vrasjen e Liridona Ademajt

PRISHTINË, 15 JANAR - Prokuroria Themelore në Prishtinë ka bërë me dije se ka ngritur aktakuzë ndaj katër personave për vrasjen e 30 vjeçes Liridona Ademaj në nëntor të vitit 2023, pas përfundimit të hetimeve. Fillimisht rasti ishte raportuar si "grabitje me pasoja të vrasjes" por, dy ditë më vonë, Policia e Kosovës njoftoi se lidhur me rastin ka arrestuar dy persona. Në mesin e tyre ishte edhe bashkëshorti i Liridonës, Naim Murseli.



Murseli, me të cilin Liridona jetonte në Suedi dhe kishte dy fëmijë, është në mesin e të akuzuarve për vrasjen e saj. Tre të akuzuarit e tjerë janë Kushtrim Kokalla, Granit Plava dhe një person i katërt, emri i të cilit nuk u theksua gjatë konferencës së Prokurorisë Themelore të Prishtinës.
Prokurorja e rastit, Javorka Përlinçeviq, tha se nuk mund të japë shumë hollësi rreth aktakuzës, por shtoi se, gjatë kohës që jetonin në Suedi, Liridona dhe Naimi kishin "marrëdhënie të trazuara martesore", si pasojë e të cilave erdhën edhe problemet pronësore. "Arsyet e tjera që kishte Naimi për të planifikuar dhe kryer këtë vrasje mund t'i mësoni në gjykatë kur të fillojë seanca kryesore", tha Përlinçeviq, e cila tha se gjetja e motivit të vrasjes kishte bërë që procesi i ngritjes së aktakuzës të merrte më shumë kohë.
Për të arritur deri te kjo informatë, prokurorja bëri me dije se ka pasur bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse në Suedi, ku Naim Murseli dhe Liridona Ademaj jetonin. Nga autoritetet në Suedi, Prokuroria kishte kërkuar të dhëna rreth jetës dhe marrëdhënieve martesore të Murselit dhe Ademajt për të zbuluar nëse kishte ndonjë problem mes tyre. "Vetëm atëherë arritëm të krijojmë një pamje të plotë të jetës së tyre dhe ta gjejmë motivin që e shtyu Naim Murselin ta marrë vendimin për largimin e Liridonës, për të mos thënë likuidimin e saj, sepse mënyra e kryerjes së veprës tregon qartë një akt të tillë si likuidim", tha Përlinçeviq.
Ndërkohë në konferencën e mbajtur për këtë rast, kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Zejnullah Gashi, tha rasti ka qenë jashtëzakonisht i ndjeshëm dhe se janë zhvilluar hetime në shumë dimensione. "Kjo është vepër penale e vrasjes së rëndë e kryer nga anëtari i familjes dhe e kryer në mënyrë dinake, andaj duke qenë e tillë, presim nga Gjykata një dënim kapital", tha Gashi.
Pas konferencës, vëllai i Liridonës, Leonard Ademaj, tha se ende nuk e kanë lexuar aktakuzën, por se shpreson që "sa më shpejt drejtësia të vijë në vendin e vet".
Liridona Ademaj ishte vrarë në moshën 30-vjeçare, më 29 nëntor të 2023-s, në rrugën "Dalip Alshiqi" në Prishtinë. Prokurorja e rastit tha gjatë konferencës së 15 janarit se Naim Murseli ka "planifikuar gjithçka", ndërsa i quajti Murselin, Kokallën dhe Plavën "ekzekutues të drejtpërdrejtë" të Liridonës. "Sa i përket ekzekutuesit të katërt, mendoj se nuk është etike të përmendet emri i tij, pasi ai nuk ka qenë i përfshirë drejtpërdrejt në kryerjen e veprës penale. Ai është përfshirë në këtë aktakuzë në një mënyrë të tërthortë dhe jo drejtpërdrejt në kryerjen e veprës penale", tha Përlinçeviqi.
Gjykata Themelore në Prishtinë ua ka vazhduar disa herë masën e paraburgimit tre të dyshuarve për vrasjen e saj, Naim Murselit, Kushtrim Kokallës dhe Granit Plavës - për herë të fundit më 27 dhjetor të vitit të kaluar.
Ndërsa të akuzuarit të katërt në këtë rast, Gjykata Supreme ia kishte ndërprerë masën e paraburgimit, duke ia mundësuar të mbrohet në liri. Ai ishte arrestuar më 9 dhjetor, nën dyshimin se ia kishte shitur armën dorasit.
Familja e Liridonës kishte kërkuar rivarrosjen e trupit të saj pranë varrezave të prindërve të saj, ndërsa aktivistët për të drejtat e grave kanë kërkuar që Liridona të mos identifikohej më me mbiemrin e bashkëshortit, por me atë të familjes së saj, Ademaj.
Zemërim të madh kishte shkaktuar edhe fakti që burri i saj kishte qenë pjesë e ceremonisë së varrimit.
Rasti i vrasjes së 30 vjeçes, nënë e dy fëmijëve, është dënuar rëndë në Kosovë dhe liderët politikë të vendit kanë kërkuar drejtësi për rastin e saj.
Nga viti 2010 deri më tani në Kosovë janë vrarë rreth 60 gra. Në të shumtën e rasteve, autorë të vrasjeve kanë qenë bashkëshortët.
Sipas organizatave që merren me të drejtat e grave, mesazhe "trimëruese" dorasëve është duke u dërguar sistemi i drejtësisë në Kosovë me, siç thuhet, "dënimet e lehta".

### 58 gra të vrara gjatë 14 vjetëve

Nga viti 2010 deri në prill të vitit 2024 në Kosovë janë vrarë 58 gra. Organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në disa raste, kanë fajësuar autoritetet për dështim në mbrojtjen e grave të rrezikuara nga dhuna. Në të shumtën e rasteve autorë të vrasjeve kanë qenë bashkëshortët, pastaj baballarët dhe djemtë.

## Rama pret në takim ambasadorin e Tajvanit, diskutojnë për ura të reja miqësie në të ardhmen

PRISHTINË, 15 JANAR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka pritur ambasadorin e Tajvanit në odën e kryeqytetit. Ata bashkë ndanë simbolika që identifikojnë qytetet tona dhe kulturën tonë. "Mirënjohja është një vlerë që duhet ta kultivojmë çdo ditë, sepse progresi ynë si komb është ndërtuar edhe falë miqve tanë ndërkombëtarë. Bashkëpunime të tilla janë një frymëzim për brezat e rinj që të vlerësojnë dhe të ndërtojnë ura të reja miqësie në të ardhmen. Faleminderit, miqve të Tajvanit për ndihmën dhe mbështetjen tuaj! Kryeqyteti është dhe do të mbetet mirënjohës!"



# Parku i erës në Bajgorë, projekti më i madh i energjisë së ripërtërishme në Kosovë



**Prishtinë, 15 janar -** Në fshatin Bajgorë të komunës së Mitrovicës, rreth 50 kilometra larg Prishtinës, ndodhet parku i erës i përfunduar në vitin 2021, i cili paraqet edhe projektin më të madh të energjisë së ripërtërishme në vend.
27 turbina prodhojnë rreth 105 megavate energji elektrike, një sasi e vogël krahasuar me nevojat e vendit që prodhon më shumë se 90 për qind të energjisë nga qymyri, ndërsa përpiqet ta arrijë hapin me pjesën tjetër të Evropës në kalimin në më shumë burime të ripërtërishme. Autoritetet thonë se nga projektet që janë në faza të ndryshme të zhvillimit, në tërësi pritet të prodhohen rreth 520 megavate energji e ripërtërishme. “Për krahasim në 40 vitet e fundit në Kosovë janë ndërtuar rreth 300, kurse rreth 220 në këto dy dekadat e pasluftës. Do të thotë po flasim për një kapërcim edhe cilësor në kuptim të burimeve që do të përdoren, teknologjive inovative, por edhe sasior në kuptim të sasisë së kapaciteteve të reja që po shtohen”, thotë për Zërin e Amerikës ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli.
Në vitin 2020 Kosova, krahas vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor, ka nënshkruar Deklaratën për Agjendën e Gjelbër, përmes së cilës zotohet se deri në vitin 2050 do t’i japë fund prodhimit të energjisë nga qymyri dhe të kalojë në burime të ripërtërishme.
Një raport i Bankës Botërore vlerëson se Kosovës i duhen të paktën 10 gigavatë kapacitete të reja në mënyrë që ta përmbushë këtë synim, ndërsa thuhet se kjo mund t’i kushtojë vendit deri në 4.5 miliardë euro.
Rizvanolli tha në një bisedë me Zërin e Amerikës se kalimi në burime të energjisë së ripërtërishme shpejt dhe plotësisht është i pamundur teknikisht dhe financiarisht, por se përpjekjet janë të vazhdueshme për një të ardhme më të mirë, të sigurt dhe më të pastër. “Po punojmë me intensitet të shtuar. Natyrisht jemi realistë që kalimi në burime të pastra, të ripërtërishme nuk bëhet brenda natës, andaj kapacitetet tona të thëngjillit duhet të jenë më efiçiente dhe më pak ndotëse për ambientin, ndërkohë jemi duke punuar edhe në këto dhe ky është miksi i energjisë që kemi zgjedhur në bazë të përballueshmërisë së çmimit, edhe sigurisë së furnizimit dhe sigurisht ndotjes minimale”, tha ajo.
Njohësi i kësaj fushe, njëherësh ish-ministër i Energjisë, Ethem Çeku, i tha Zërit të Amerikës se Kosova ka humbur pavarësinë energjetike për shkak të keqmenaxhimit, ndërsa zhvillimi i këtij sektori ka ngecur. “Tani jemi krejtësisht të varur nga zhvillimet që ndodhin në rajon. Si do të përballemi me këtë fazë, e vetmja rrugë apo një rrugë që na ka mbetur është energjia alternative, të diellit apo solare, një pjesë të erës sepse te hidro ne kemi problem meqë Kosova nuk është e pasur me ujëra”, thotë ai.
Në variantin më të mirë me shfrytëzimin e të gjitha burimeve ekzistuese, thotë zoti Çeku, Kosova mund t’i instalojë 7 mijë e 700 megavate që nuk përkthehen patjetër në prodhim. “Kosova prapë do të jetë e varur nga blerja e energjisë me çmime të shtrenjta nga vende të ndryshme të rajonit. Prandaj ne nuk kemi alternativë tjetër, duhet ta mbështesim energjinë solare dhe të erës, duhet ta mbështesim idenë e investimeve të përbashkëta me Shqipërinë në tregun e energjisë. Duhet ta shohim mundësinë e zhvillimit të dy minihidrocentealeve reverzibile nga prodhimi i energjisë solare dhe energjisë alternative qoftë atë të Ujmanit, qoftë të Vermicës. Do të thotë të kemi dy hidrocentrale reverzibile”, thotë ai.
Ai thotë se Kosova duhet t’i ndjekë me vëmendje zhvillimet që ndodhin në vendet e rajonit si Bullgaria, e cila aktualisht është duke ndërtuar dy reaktorë me energji nukleare. “Janë dy rrugë, Shqipëria dhe Bullgaria për ne, për një treg të përbashkët të investimeve sepse në Bullgari kemi investime amerikane. Në qoftë se jemi në vija politike të amerikanëve, atëherë e kemi shumë të lehtë të hyjmë në negociata me kompani amerikane dhe Bullgarinë që të kemi një degëz të furnizimit të saj”, thotë Çeku. “Ne kemi bërë një hap shumë të rëndësishëm, bashkëdyzimin e tregut energjetik me Shqipërinë, duke lansuar Bursën Shqiptare Kosovë - Shqipëri ALPEX që nga shkurti i vitit të kaluar dhe që është funksionale tashmë. Në plan është që ky bashkëpunim të zgjerohet edhe me Maqedoninë e Veriut dhe me Greqinë. Sa iu përket investimeve të përbashkëta, ne kemi pasur disa ide dhe iniciativa, mirëpo ende nuk janë në fazë të zhvillimit”, thotë Rizvanolli.
Çeku vlerëson se pa konsensus politik vendor dhe ndërkombëtar nuk mund të zhvillohet sektori i energjisë, ndërsa thekson se mungesa e zhvillimit të tij cenon edhe sigurinë shtetërore. “Duhet ta kthejmë rolin e USAID-it, Bankës Botërore, GIZ-it, Zyrës së Bashkimit Evropian drejt energjisë për të ndërtuar një konsorcium të mirë që do të hartonte politika zhvillimore për sektorin e energjisë sepse Kosova do të mbetet e varur nga importet e shtrenjta deri në vitin 2050. Pra ne do të humbim mjete të konsiderueshme nga buxheti i Kosovës për blerje të energjisë elektrike”, thotë zonja Rizvanolli.
Kosova aktualisht përmbush shumicën e nevojave të saj me energji elektrike nga dy termocentrale të vjetra që punojmë me qymyr linjit dhe vlerësohen të dëmshme për mjedisin. Megjithatë nevojat e Kosovës për energji elektrike tejkalojnë kapacitetet e prodhimit, sidomos gjatë dimrit, duke bërë që vendi të përballet me probleme të shumta si importet e shtrenjta, reduktimet dhe ndotja e lartë e mjedisit.

# Kryetari i Odës së Hotelerisë dhe Turizmit, Sogojeva: Nuk ka pasur largime masive të punëtorëve pas heqjes së vizave




**Prishtinë, 15 janar -** Pavarësisht prej paralajmërimeve të shumta që ishin bërë nga disa ekspertë të ekonomisë, të cilët kishin parashikuar një largim masiv të punëtorëve nga Kosova pas heqjes së vizave, një fenomen i tillë nuk ka ndodhur.
Kryetari i Odës së Hotelerisë dhe Turizmit të Kosovës, Hysen Sogojeva, në një intervistë për “Telegrafi”-n, tha se një vit pas heqjes së vizave nuk ka pasur migrim të madh të punëtorëve.
“Vetë fakti që popullata është më e lirë, do të thotë shumica absolute vendosin më lirshëm se ku të orientohen edhe ku gjejnë kushte më të mira, është normale që ata të shkojnë. Kjo e ka mundësuar, për shembull, që madje edhe nga koha sezonale që punojnë, të veprojnë edhe jashtë Kosovës por, siç po shihet, nuk është ajo pritshmëria e vlugut të madh të largimit”, është shprehur ai.
Sogojeva tha se nga largimet që kanë ndodhur, ka pasur shqetësime në sektorin e hotelerisë dhe turizmit se a mund të gjenden kamerierë dhe kuzhinierë të mirë.
“Normalisht çdoherë gjendet alternativa por, megjithatë, ka shqetësime, sepse ka pasur për shembull kuzhinierët e mirë dhe kamerierët, por në momentin kur dikush largohet prej aty nuk është lehtë të bëhet zëvendësimi, do të thotë edhe nëse e zëvendëson, nuk mundesh ta zëvendësosh me atë që ka qenë i mirë. Kështu që është vërejtur shqetësimi po, megjithatë, janë gjetur edhe nuk kemi asnjë ankesë”, tha ai. Sipas Sogojevës, liberalizimi i vizave ka ndikuar të përmirësohen kushtet për ata që punojnë në sektorin privat. “Megjithatë është përmirësuar dukshëm, do të thotë paga e këtyre punëtorëve, të cilët merren me këtë veprimtari dhe, siç po shihet, do të thotë dita ditës ka filluar të bjerë në binarë dhe nuk kemi as migrime, ose lëvizje të mëdha të punëtorëve, siç është parashikuar”, sqaroi ai.
Më tutje, në intervistë ai deklaroi se në të ardhmen janë disa gjëra që mund të ndikojnë nëse të rinjtë mund ta gjejnë veten në Kosovë ose jo.
“Ndoshta në të ardhmen do të shohim se a mund të ketë, do të thotë varësisht prej shkallës së zhvillimit ekonomik, varësisht prej situatës në përgjithësi ekonomike të shtetit, varësisht prej politikëbërjes, do të thotë hartimet politike, çfarë e bën shteti, edhe këto e bëjnë të vetën që nesër pasnesër të rinjtë, ndoshta kur nuk e gjejnë veten në Kosovë, mund të mendojnë për t’u larguar”, u shpreh Sogojeva.

# As floriri i Hollywood-it nuk i bën dot ballë fuqisë së natyrës

Zjarri më shkatërrues në historinë e Los Angeles-it, i cilësuar si i tillë nga presidenti Joe Biden, vazhdon të përhapet, duke zhvendosur mbi 150 mijë banorë. Të pasurit e famshëm janë strehuar në hotele luksoze si Beverly Hills Hotel, ndërsa qytetarët e zakonshëm kanë gjetur strehim te të afërmit ose në hangarë të improvizuar.

Pamjet janë apokaliptike: kolona tymi që errësojnë horizontin, qielli që vezullon i kuq, kodra të gjelbra dhe vila ëndrrash, që tani shtrihen nën shtresa hiri. Flakët nuk bëjnë dallime – ato fshijnë gjithçka, nga pallatet popullore deri te rezidencat e miliarderëve.

E megjithatë, në lajme dhe në rrjetet sociale, duket sikur po digjen vetëm vilat e Paris Hilton-it apo Anthony Hopkins-it. Kopshtet e tyre të kuruara dhe pishinat e mrekullueshme, tashmë të shkatërruara, na japin një goditje të thellë, sepse ato janë pjesë e një imagjinate kolektive që simbolizon ëndrrën amerikane. Los Angeles, qyteti ku sukseset duken gjithmonë brenda mundësive, është bërë tani një kujtesë e dhimbshme se ëndrrat mund të jenë po aq të brishta sa vetë jeta.

Ky është një memento mori, një reflektim mbi përkohshmërinë e gjithçkaje. Hollywood-i, i njohur për imazhin e pavdekshëm të heronjve të tij, duket i pafuqishëm përballë fuqisë së natyrës. Dhe ja ku janë ata – aktorët dhe yjet që shpesh përfaqësojnë fantazitë dhe zilitë tona – të zhveshur nga privilegjet, njerëzorë, të pambrojtur përballë një armiku që nuk kursen askënd. Ndoshta pikërisht ky kontrast bën që këto zjarre të na prekin kaq shumë. Ato na kujtojnë që jeta është e brishtë dhe se, në fund, askush, as edhe "Supermani" i famshëm, nuk është i paprekshëm në tokën e ëndrrave. Endrrat janë të çmuara, por gjithmonë kalimtare! / bota.al



# Musk dërgon Cybertruck Tesla dhe Internet falas në Los Angeles



Pas kritikave ndaj reagimit të autoriteteve lokale dhe shtetërore ndaj zjarreve në Los Angeles, Elon Musk ka ndërmarrë një iniciativë të re për të ndihmuar zonat më të prekura. Përmes platformës së tij sociale, X (ish-Twitter), ai njoftoi dërgimin e një konvoji me Cybertruck Tesla, të pajisur me teknologjinë Starlink dhe Wi-Fi falas, në zonat e prekura si Los Angeles dhe Malibu.

"Do të vendosim Cybertruck në formë rrjeti për të siguruar lidhje interneti në zonat më të goditura të metropolit," shkroi Musk në një postim.

Zjarret, që nisën të martën e kaluar, kanë shkaktuar shkatërrime masive dhe reagimi i autoriteteve ka qenë një temë e nxehtë debati. Musk ka përdorur platformën e tij për të shprehur kritika ndaj politikave të diversitetit, emigrantëve dhe guvernatorit demokrat të Kalifornisë, Gavin Newsom, duke nxitur debat publik.

Megjithatë, dje ai ndryshoi qasje duke treguar një anë më të përkushtuar ndaj ndihmës. Përveç shpërndarjes së pajisjeve dhe burimeve nga kompanitë e tij Tesla dhe SpaceX, Musk ka vizituar zjarrfikësit dhe ekipet e shpëtimit për t'i falënderuar për punën e tyre. / bota.al




# Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

# Përmbyllet kampi stërvitor katërditor me futbollistët kandidatë potencialë për Përfaqësuesen A

PRISHTINË, 15 JANAR - Ka përfunduar kampi stërvitor katërditor i organizuar nga FFK-ja me futbollistët kandidatë potencialë për Përfaqësuesen A. Gjatë këtyre ditëve intensive futbollistët patën mundësinë të punojnë me përzgjedhësin e Përfaqësueses A, Franco Foda dhe stafin e tij, duke treguar aftësitë e tyre dhe duke njohur nga afër filozofinë e lojës së trajnerit gjerman. Gjatë këtij kampi puna u përqendrua në stërvitje taktike dhe teknike, si dhe në analiza të ndryshme, ndërsa bashkëpunimi dhe atmosfera pozitive mes lojtarëve ishin në nivelin më të lartë. Në përfundim të kampit lojtarët u shprehën të kënaqur me organizimin e këtij kampi dhe me metodologjinë e punës së trajnerit Foda, teksa vlerësuan se ky kamp do t'i motivojë ata për të vazhduar të punojnë me përkushtim për arritjen e synimeve të tyre për ta përfaqësuar Kosovën në nivelet më të larta. Grumbullimi i radhës për Përfaqësuesen A do të zhvillohet në muajin mars në kuadër të përgatitjeve për ndeshjen e "play-off"-it kundër Islandës, një përballje kjo që mbart rëndësi të madhe për ngjitjen e Kosovës në Ligën B të Ligës së Kombeve.



# Kastriot Jupa vazhdon kontratën me Cottbusin

PRISHTINË, 15 JANAR - Lojtari i rëndësishëm i Përfaqësueses së Kosovës në hendboll, Kastriot Jupa, e ka vazhduar edhe për dy vjet kontratën me klubin gjerman Cottbus. Me kontratën e re, pivoti Jupa do të jetë te Cottbusi deri në verën e vitit 2027. Ai është shumë i rëndësishëm te Cottbusi, ndërsa te Kosova është zëvendëskapiten dhe lojtari me më së shumti paraqitje jo vetëm në hendboll. Te Cottbusi janë shprehur të lumtur për vazhdimin e bashkëpunimit me hendbollistin "dardan". Jupa në fund të dhjetorit e pësoi një lëndim të gjurit, ndërsa javën e kaluar iu nënshtrua operimit, që kaloi me sukses. Ka dëmtuar ligamentet dhe për të ky edicion ka përfunduar. Për shkak të lëndimit mungoi në Përfaqësuese në turneun "Yellow Cup". Federata e Hendbollit e Kosovës i dëshiron shërim të suksesshëm dhe kthim të shpejtë në fushën e lojës.




## SHKURT

### Rrahmani, afër vazhdimit të kontratës me Napolin

Kapiteni i Kosovës, Amir Rrahmani, po konfirmohet lojtar i paprekur te skuadra e Napolit. Drejtuesit e Napolit po duan ta mbajnë edhe më gjatë Rrahmanin në ekip dhe tashmë kanë nisur negociatat për rinovimin e kontratës. Kontrata aktuale Rrahmanit i skadon në vitin 2027 dhe me rinovimin e saj, 30-vjeçari do të jetë pjesë e Napolit deri në verën e vitit 2028. Rrahmani është pjesë e Napolit që prej vitit 2020 dhe është titullar i padiskutueshëm, ndërsa me këtë skuadër e ka fituar titullin e kampionit të Italisë në sezonin 2023/24. Këtë sezon Rrahmani ka 21 paraqitje për Napolin në të gjitha garat, ndërsa ka shënuar 1 gol dhe ka bërë 2 asistime në Serinë A.

### Manaj kërkohet nga Beshiktashi

Rey Manaj shumë shpejt mund të jetë shok skuadre me Ernest Muçin dhe Milot Rashicës. Sipas medieve turke, sulmuesi i Sivassporit shikohet nga Beshiktashi si profili i duhur për ta përforcuar repartin e sulmit. Shtypi turk shkruan se kartoni i Manaj, i cili vlen rreth katër milionë euro, është i përballueshëm për Beshiktashin. Klubi në fjalë ka nisur bisedimet me Sivassporin pasi ka marrë miratimin e shqiptarit. Futbollisti i kombëtares së Shqipërisë ka një karrierë të pasur, duke qenë pjesë e skuadrave si: Watford, Barcelona, Spezia, Inter dhe Granada. Këtë sezon lushnjari në 12 ndeshje të zhvilluara ka katër gola të realizuara dhe një asistim, teksa me kombëtaren ka shtatë gola në total.

### Simon Simoni paraqitet te Kaiserslauterni

Portieri shqiptar Simon Simoni është bashkuar me Kaiserslautern. Simoni firmosi me skuadrën e Bundesligës së dytë, në formë huazimi nga Eintracht Frankfurt. Zyrtarizimi u bë prej klubit nga Frankfurti, nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale. "Është konfirmuar transferimi i parë dimëror i sezonit 2024/25: Simon Simoni tani po zgjeron ekipin e portierëve të 1. FC Kaiserslautern. 20-vjeçari po transferohet në formë huazimi nga klubi i Bundesligës Eintracht Frankfurt. I lindur dhe i rritur në Shqipëri, Simon Simoni gjithashtu hodhi hapat e tij të parë në futboll në vendlindje dhe nënshkroi kontratën e parë profesionale me klubin e atëhershëm të divizionit të parë shqiptar FK Dinamo Tirana në vitin 2021. Në janar të vitit 2023 lojtari shqiptar U21 u transferua në klubin e Bundesligës Eintracht Frankfurt dhe u huazua në FC Ingolstadt 04 verën e kaluar. Pas përfundimit të parakohshëm të kësaj huazimi, FCK siguroi shërbimet e talentit të portierit 1.95 metra të gjatë", ka njoftuar klubi gjerman.

### Ibrahimoviqi pas kalimit në Lazio: Njoh Hysajn, kemi prejardhje nga i njëjti vend

Futbollisti shqiptar, Arijon Ibrahimoviq, u largua nga Bayern Muncheni dhe u transferua në formë huazimi te skuadra nga Italia, Lazio. Gjatë intervistës së parë për faqen zyrtare të klubit nga Seria A, Ibrahimoviqi shqiptar ka thënë se njeh disa lojtarë, veçanërisht mbrojtësin e njohur shqiptar, Elseid Hysajn. "Kam njohur disa nga lojtarët e Lazios, veçanërisht Elseid Hysajn, për shkak të prejardhjes sonë të përbashkët", u shpreh Ibrahimoviqi. Kujtojmë që Arijoni u huazua për gjashtë muaj te Lazio, por kjo e fundit ka të drejtë ta blejë kartonin e plotë në fund të sezonit për 8 apo 10 milionë euro. Ibrahimoviqi e njeh shumë mirë ligën italiane, pasi sezonin e kaluar ishte pjesë e Frosinones.

## Portieri Arion Ymeri rikthehet te Drenica

**Skenderaj, 15 janar** - Skuadra e Drenicës po vazhdon të përforcohet për sezonin pranveror në Ligën e Parë të Kosovës në futboll. “Kuqezinjtë” pas transferimit të Igball Jasharit, Arbër Shalës dhe Armend Gashit e kanë transferuar edhe portierin Arion Ymeri. Ky i fundit ka luajtur për disa skuadra, derisa sezonin vjeshtor i mbrojti ngjyrat e Lirisë. “Arion Ymeri rikthehet në ‘folën’ e tij. Më kënaqësi ju njoftojmë për arritjen e marrëveshjes me portierin Arion Ymeri. Portieri i cili është produkt i Shkollës së Futbollit ‘Drenica’ tashmë është rikthyer në 'shtëpinë' e tij, pas disa vitesh të kaluara në skuadra si Trepça ’89, SC Gjilani, FC Suhareka e FC Liria. Ymeri tashmë do të jetë vlerë e shtuar për ekipin tonë. Arioni ka arritur marrëveshje me klubin deri në përfundim të këtij edicioni. Mirë se vjen Arion! Bashkë drejt Superligës”, thuhet në njoftimin e Drenicës.
Skuadra kuqezi është duke i vazhduar përgatitjet në Shqipëri, kurse sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e parë me 31 pikë, katër pikë më shumë se Vëllaznimi që zë vendin e dytë.



# Evropa bën me rotacion garat e saj për të mos humbur nga harta e Formula 1

**Barcelonë, 15 janar** - Botërori i Formulës 1 do të vijojë të mbesë në limitin e 24 garave, ndërkohë që numri i kërkesave në rritje për të mirëpritur një garë është shumë i madh. Kjo do të sjellë një alternim të pistave që do të organizojnë garat e Formula 1. Duke nisur nga viti 2026, përcaktimi i pistave që do ta mirëpresin Botërorin F1 do të bëhet me rotacion. Nëse vendet arabe e kanë më të lehtë të garantojnë një vijueshmëri të pistave të tyre për shkak se i kanë të ardhurat, vendet evropiane e kanë më të vështirë. Kështu, Katari paguan çdo vit 50 milionë dollarë për të siguruar një vend në Formula 1, ndërsa pista si SPA (Belgjikë) luftojnë për t’i përmbushur kërkesat financiare të këtij sporti. Për pasojë, për të mos humbur nga harta e garave, këto pista që kanë vështirësi financiare për të organizuar çdo vit një garë do të alternohen mes tyre. Kjo pritet të ndodhë mes pistave si SPA dhe Imola (Itali), apo mes dy qyteteve më të mëdha të Spanjës, Barcelonë dhe Madrid, që pritet ta bëjnë me rotacion organizimin e garave. Shumë vende si Kuvajti, Afrika e Jugut, Tajlanda dhe Koreja e Jugut janë të gatshme të ofrojnë miliona dollarë vetëm për të marrë një vend në kalendarin e F1. Pra, vendeve evropiane nuk u mbetet gjë tjetër veçse ta rrisin kontributin e tyre financiar për të organizuar një garë çdo vit ose ta pranojnë kompromisin, për t’u alternuar me një pistë tjetër. Rotacioni nuk është një opsion i ri në F1, pasi një gjë të tillë e ka përdorur më parë Gjermania, kur alternonte dy pistat e saj të Hockenheim dhe Nurburgring (deri në vitin 2010). E gjithë kjo gjë bëhet për të mos rritur numrin e garave në Formula 1, ndërkohë që është e qartë që ky sport ka fituar një popullaritet të jashtëzakonshëm kudo në botë.




# Cavaliersi kthehet te fitorja, spikat Mitchelli me 35 pikë

**Ohio, 15 janar** - Kryesuesit e Clevelandit rikthehen te fitorja në kampionat, duke mundur me rezultat 127-117 Indiana. Donovan Mitchell me 35 pikë ishte më i miri në fushë për Cavaliersin, mbështetur edhe nga Garlandi me 24 pikë. Fiton edhe Atlanta, 122-117 ndaj Phoenixit, sfidë ku Trae Young realizoi 43 pikë. Ndërsa 35 pikët e Bookerit për miqtë mbetën për statistikë. Fitore të madhe korri jashtë fushës Brooklyni, që mundi me shifrat 131-114 Portlandin, ku protagonist ishte Johnson me 24 pikë. Në Perëndim, në krye të renditjes qëndron Oklahoma, që fitoi me rezultat 118-102 në fushën e Philadelphias. Shai me 32 pikë e Williamsi me 24 bënë dallimin në fushë. Nuk zhgënjeu Milwaukee, që falë një “triple double” të Antetokoumpos (33 pikë, 11 rebounde, 13 asistime) mundi me rezultat 130-115 Sacramenton.



**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Indiana - Cleveland | 117-127 |
| Philadelphia - Oklahoma | 102-118 |
| Atlanta - Phoenix | 122-117 |
| Chicago - New Orleans | 113-119 |
| Milwaukee - Sacramento | 130-115 |
| Dallas - Denver | 99-118 |
| Portland - Brooklyn | 114-132 |

SHKURT

### Henry mbron Mbappe: Është ndër më të mirët

Thierry Henry ka dalë në krah të Kylian Mbappes i cili është kritikuar gjerësisht që kur u transferua te Real Madridi me kosto zero në verën e vitit 2024. Francezi pritej të dominonte në Spanjë dhe nuk ka bërë shumë keq, me 14 gola në të gjitha kompeticionet. Henry, i cili shënoi 360 gola në karrierën e tij në klub si dhe 51 për Francën, përmendi se Mbappe po gjykohej thjesht në bazë të asaj që ka arritur në të kaluarën. “Po të ishte dikush tjetër do të thoshim se shënon gola, tani po gjykojmë në bazë të asaj që ka bërë më parë. Është krejtësisht normale, kur nuk jeni mësuar me të, të gjendesh në një situatë të caktuar ku njerëzit mund t’i shohin dobësitë tuaja. Ndërsa më parë nuk i kemi parë kurrë. Ne e dimë shumë mirë se ai është një nga lojtarët më të mirë në botë. Dhe e përsëris, por le të jemi të lumtur që ai është francez. Tani ne duhet të dimë nëse po më bëjnë pyetje për lojtarin apo njeriun”, ka deklaruar Henry.

### Kolo Muani pranon t’i bashkohet Juventusit

Randal Kolo Muani e ka pranuar Juventusin si destinacion i ardhshëm. Lajmin e ka dhënë eksperti i transfereve, Fabrizio Romano. Marrëveshja është arritur deri në qershor nga Paris Saint-Germaini dhe nuk do të përfshihet opsioni i blerjes definitive. Rroga e lojtarit për këta gjashtë muaj do të mbulohet nga gjiganti italian. Kolo Muani e pranoi propozimin e “Bianconeri”-t pavarësisht prej dy ofertave që i kishte nga Premierliga. Sulmuesi francez do të fluturojë drejt Torinos gjatë kësaj jave dhe më pas do t’u bashkohet shokëve të rinj të ekipit, me synimin që do të luajë rregullisht dhe që do të japë kontribut për Bardhezinjtë.

### Araujo ndryshon mendje, nuk largohet nga Barça

Ronald Araujo duket se ka vendosur për të qëndruar te Barcelona, së paku deri në qershor dhe mos të largohet gjatë janarit. Drejtori sportiv i Barcelonës, Deco, e ka bindur Ronald Araujon që të mos largohet nga klubi në janar, raporton “Mundo Deportivo”. Araujo ka ndryshuar mendje dhe do të qëndrojë. Klubi madje pret që mbrojtësi të nënshkruajë një kontratë të re me marrëveshjen e tij aktuale që skadon në vitin 2026. Mbrojtësi uruguaian mendonte transferimin te Juventusi, skuadër e cila iu afrua me një ofertë joshëse duke i premtuar më shumë kohë për të luajtur.
Fillimisht u besua se Araujo ishte vendosur të largohej, madje u kishte thënë shokëve të skuadrës për dëshirën e tij për t’u larguar. Megjithatë, largimi i tij do ta kishte dëmtuar mbrojtjen e skuadrës së Barçës për sezonin duke marrë parasysh dëmtimin e Inigo Martinez dhe përvojën e Araujo si kapiten.

## Guardiola: Duhej ta kishim mbyllur ndeshjen pas avantazhit 2-0

Pas dy fitoreve ndaj Leicesterit dhe West Hamit, skuadra e Manchester Cityt “ngeci” sërish në Premierë Ligë, duke barazuar 2-2 me Brentfordin jashtë fushës. Kampionët e Anglisë shpërdoruan një avantazh 2-0, duke pësuar dy gola në 10 minutat e fundit. “Ajo që më mungoi ishte se nuk morëm vendimet e duhura në fundin e ndeshjes. Ne fitonim topa të gjatë dhe mund të vraponim në fushë për t’iu larguar zonës sonë, por nuk morëm vendimet e duhura”, u shpreh Guardiola. Më tej, trajneri i Manchester Cityt ka shtuar: “Më pëlqen mënyra se si luan Brentfordi. Arrin gjithnjë të krijojë shumë raste. Në avantazhin 2-0 ne duhej ta mbyllnim ndeshjen në favorin tonë dhe t’i merrnin tri pikët”. “Për fat të keq, nuk kemi një lojtar specifik për të mbrojtur një rezultat në kuadratin tonë. Ne duhet ta bëjmë atë duke qarkulluar topin në tri të katërtat e fushës, duke kontrolluar lojën”, ka deklaruar Guardiola.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria –Vlada-Government*
*MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT*
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
*AGENCIJA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE*
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 182/1
Dt: 15.01.2025

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2021, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Rregullores (Qrk) Nr:19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

**KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS**

| Niveli | Institucioni/Shkolla | Vendi | Pozita: | Vend i lirë/ Zëvendësim | Numri i pozitave | Koeficienti i pagës |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **SHML** | **Qendra e Kompetencës "Shtjefën Gjeçovi" Prishtinë** | **Prishtinë** | **Mësimdhënës/e për Gjuhë gjermane** | **Vend i lirë** | **1** | **5.8** |

**I. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike). Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.

**II. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi)
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat të noterizuara)
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, **duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI**
- Çertifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT
- Dëshmi të përvojës së punës ne arsim (kontratat e punës ose vërtetim)
- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Licencën e mësimdhënësit/es, sipas procedurave për lëshimin e licencës për mësimdhënës/e, nëse një gjë e tillë nuk është shfuqizuar përmes një akti nënligjor të MASHTI për rregullimin e provimit shtetëror të mësimdhënësit;
- Përjashtimisht për kandidatët që konkurrojnë për pozitën e mësimdhënësit/es fillestar/e, nuk kërkohet licenca;
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre (Udhëzimi për përgatitjen e portofolies Profesionale merret në Qendrën e Kompetencës përkatëse me rastin e aplikimit).

**III. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kritereve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar **(Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138)** dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të **MAShTI-it: UA Nr. 05/2021,** si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik**.**

**Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Gjuhë gjermane në shkollë të mesme të lartë**:

- Niveli master arsimor (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

**IV. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;**

